



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
Këshilli i Gjykatës

Nr. 25 Prot.

Tiranë, më 27.11.2025

V E N D I M

Nr. 16, datë 27/11/2025

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 6, DATË 21.03.2024, “PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË KOLEGJEVE TË GJYKATËS SË LARTË SI DHE CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË TRUPAVE GJYKUESE TË SECILIT KOLEGJ”

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 23 si dhe të shkronjës “ç” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar),

Duke konsideruar se gjyqtari Asim Vokshi është emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, dhe për pasojë lind nevoja për riorganizimin e trupave gjykuese të Kolegjit Administrativ pranë të cilit ai ishte anëtar;

Bazuar në mendimin e dhënë nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për ndarjen e gjyqtarëve në kolegje dhe përbërjen e trupave gjykuese në këtë Gjykatë;

Këshilli i Gjykatës së Lartë, në mbledhjen e datës 27.11.2025,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 6, datë 21.03.2024 “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykuese të secilit koleg”, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në Kolegjin Administrativ, **Trupi gjykues nr. 2** përbëhet nga gjyqtarët si më poshtë:

Trupi gjykues nr. 2
Enkelejda Metaliaj
Arbena Ahmeti
Sokol Ngresi / Gentian Medja

2. Për çështjet administrative që janë planifikuar të shqyrtohen në muajin dhjetor 2025 e në vijim, rendi i shqyrtimit të tyre nga **Trupi Gjykues nr. 2**, është sipas skemës si vijon:
 - a) për çështjet e planifikuara në ditët që bien në *javët tek* të muajit, në përbërje të trupit gjykues do të jetë gjyqtari Sokol Ngresi;
 - b) për çështjet e planifikuara në ditët që bien në *javët çift* të muajit, në përbërje të trupit gjykues do të jetë gjyqtari Gentian Medja.
3. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë të marrë masat për përditësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si rezultat i mbarimit të mandatit të gjyqtarit Asim Vokshi.
4. Ky vendim t'i komunikohet gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Njësisë së Shërbimit Ligjor, Kancelarit, si dhe të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

KËSHILLI I GJYKATËS

ANËTAR
ILIR PANDA

ANËTAR
KELMENT GRECA

KRYETAR
SOKOL SADUSHI